



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2020:083828
Datë:	23.04.2021
Numri i dokumentit:	01727368

P.nr. 546/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit, D. D. nga për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II nr.972/20 të datës 24.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me dt. 17.03.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Arben Hoti, i pandehuri D. dhe mbrojtësi i të pandehurit, av. D. K. sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, dhe me dt.19.04.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

D. D., i lindur me, ne, me banim ne rrugën “.....” nr.26,, i biri i S., nenës A., e gjinisë V., student ne fakultetin juridik, i pa martuar, i identifikuar me numër personal, si dhe me numër personal tjetër të shtetësisë se Malit te Zi ka numër telefoni, ka qene ne ndalim policor ne kohëzgjatje prej 48 ore. Sipas Aktvendimit RLN/II, nr.312/2020 dt. 29.06.2020 nga ora 21:30, Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 29.06.2020 rreth orës 18:30min, ne rrugën “.....” tek barriera e pylltarisë ne Pejë me dashje përmes kanosjes tenton te pengoj personin zyrtar këtu te dëmtuarin F. B. zyrtar policor, ne kryerjen e detyrave zyrtare ne atë mënyre që :pasi qe i dëmtuari ndalon veturënme targa Norvegjeze te cilën e drejtonte motra e te pandehurit dhe te njëjtën veture për shkak te skadimit te regjistrimit dhe shmangies nga pagesa e detyrueshme doganore e konfiskon për ta dërguar ne Doganë, aty vjen i pandehuri D. dhe pasi qe kërkon shpjegim për

ndalimin e motrës dhe marrjen e veturës, i drejtohet te dëmtuarit me fjalët “në kofsh p... nënë e merr veturën e me pas e sheh se kush jam unë”

- me çka ka kryer veprë penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39,40, 42, 43, 44, 69, 70, neni 401 par. 1 të KPRK-së dhe nenin 365 të KPP-së, të pandehurin:

E G J Y K O N

- I.** Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, e në të cilin dënim ka për tju llogaritur edhe koha e ndalimin në kohëzgjatje prej 48 orë,
- II.** Dënimi me burg nga pika **I.** në përputhje me nenin 44 par.1,2 të KPRK-ës, e më pëlqimin e të pandehurit, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro, e të cili dënim ka për ta paguar në afat prej 60(gjashtëdhjetë)ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, e nënë kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- III.** I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II nr.972/20 të datës 24.08.2020, kundër të pandehurit D. D. nga për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 17.03.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, prezentë kanë qene prokurori i shtetit, prokurori i shtetit, Arben Hoti, i pandehuri D. dhe mbrojtësi i të pandehurit, av. D. K. sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 248 par.5 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës ka angazhuar avokatin D. K. sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri nuk e kundërshtoj aktakuzën dhe gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri lidhur me ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, nuk ka qene me asnjë qellim të keq, e ka bere ne afekt, ne atë moment, atë dite ka punuar tere ditën dhe ka qene i lodhur, ndjehet i penduar, kërkon falje të dëmtuarve, i premtton gjykatës se nuk do të përsëris me veprime të tilla.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e lut gjykatën që të mbrojturit të tij ti merr parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajësisë qysh në shqyrtimin fillestar, i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurorit të Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës. Gjykatës i propozon që ta pranon pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit dhe të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i policit H. K. PK#8354 i datës 29.06.2020, raporti i oficerit Rr. F. B. PK#7195 i datës 29.06.2020, raporti i oficerit A. T. PK#3073 i datës 29.06.2020, intervista e të dyshuarit në polici e datës 29.06.2020, polica e sigurimit kufitar me numër 03331548, dokumentacioni norvegjez i veturës me targa si dhe CD me pamjet nga kamerat e sigurisë në vendin e ngjarjes, procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarit në Prokurori me date 14.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëshmitarit A. T. në Prokurori me date 14.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëshmitares D. D. në Prokurori me date 21.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëshmitarit S. D. në Prokurori me date 21.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit D. D. në Prokurori në prezence të mbrojtësit sipas autorizimit av. D. K. i date 21.07.2020, raporti Njoftues i Inspektoriatit Policor të Kosovës- hetuesi A. K. si dhe Aktvendimi i Doganës së Kosovës me numër 03.1.7-2020-519i datës 02.07.2020, si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në

dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit D. D. , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale si dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe se ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me burg i caktuar sipas pikës I, në dënim me gjobë sipas pikës a, të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e mori në përputhje me nenin 44 par.1,2 të KPRK-ës, e në mbështetje të pëlqimit të të pandehurit të dhënë menjëherë pas shpalljes së aktgjykimi përmes evidentimit në procesverbalin shtesë të përpiluar nga gjykata, duke ja bërë zëvendësimin të pandehurit nga burgu në gjobë.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 1,të KPP-së, e obligoi të pandehurin në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale të krijuara.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**

P.nr.546/20, dt. 19.04.2021

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.